



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



Raport i Diskutimit Publik për Draft Planin Lokal të Veprimit në Mjedis 2024-2029

Komuna e Podujevës ka marrë vendim për iniciimin e procedurave për hartimin e draftit për **Plani Lokal për Veprim në Mjedis 2024-2029**.

Grupi i Operatorëve Ekonomik N.SH. "GEO-MININGU", EDUARD LIR NR.109, Prishtinë së bashku me grupin menaxhues së Komunës së Podujevës ka përgatitur hartimin e planit lokal të veprimit në mjedis. Ky dokument paraqet gjendjen ekzistuese të mjedisit, identifikimin e problemeve kryesore në mjedis dhe caktimin e kushteve për përmirësimin e gjendjes së mjedisit në Komunën e Podujevës.

Ky draft për Planin Lokal të Veprimit në Mjedis 2024-2029 është përgatitur dhe proceduar në Kuvend më datë 04.11. 2024, hapja zyrtare e shqyrtimit publik është mbajtur me dt: 20.11.2024 në ora 08:00, debati i përgjithshëm publik me qytetar është mbajtur me dt: 03.12.2024 në ora 10:00-10:45 (është mbajtur proces verbal).

Në takimin e datës 03.12.2024 në bashkëbisedim ndërmjet Zyrtares për Mbrojtjen e Mjedisit dhe qytetarëve u parashtruan pyetjet si: a është bërë një vlerësim se sa ndikojnë në mjedis ndërtimet e larta? Zyrtarja u përgjigj se kjo pjesë nuk është përfshi në këtë plan pasi ndërtimet e larta trajtohen me Leje Mjedisore Komunale konform udhëzimit administrativ 01/2017 për dhënjen e Lejeve Mjedisore Komunale, ku me kete leje trajtohen te gjitha ndikimet e mundshme në mjedis dhe shëndet të popullatës.

Nga ky takim nuk kishte propozime për t'u përfshirë në këtë draft projekt, por u parashtruan vetëm pyetje informuese.

Shqyrtimi publik i Projekt Dokumentit ka zgjatë 30 ditë përkatësisht prej datës 20.11.2024, deri më datë 19.12.2024, sipas procedurave të përcaktuara me ligj. Brenda kësaj periudhe kohore propozimet, sugjerimet dhe vërejtjet, kanë pasur mundësinë që të paraqiten me shkrim në librin e vërejtjeve, si dhe në formë elektronike në e-mail adresat: artiola.zeneli@rks-gov.net, remzi.kodraniu@rks-gov.net dhe info.podujeva@rk-gov.net.

Në formë fizike kemi pranuar disa komente nga MMPHI, e ato janë:

- Plani hartohet për pesë vite, le të mbetet 2025-2029, pasi tani vetëm jemi në fund të vitit 2024, siç është hartuar i bie të jetë për gjashtë vite;
- Kudo që përfshihet baza ligjore të jetë duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-025 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja dhe jo në ligjin tjetër që është shfuqizuar;

- Plani i realizimit të aktiviteteve mungojnë vlerat e projekteve/aktiviteteve si dhe viti i realizimit.

Në formë elektronike kemi pranuar këto komente:

- Ky Dokument duhet të përgatitet për vitet 2025-2029, të bazohet në ligjin 08/L-025 e jo në ligjin e vjetër dhe të përmbajë statistika të viteve të fundit;
- E tërë baza ligjore të rishikohet, pasi që disa akte ligjore janë të shfuqizuara;
- Harta online të zonave të mbrojtura të komunës së Podujevës duhet të jetë aktive;
- Të dhënat e raportuara në kapitullin e dytë që kanë të bëjnë me Profilin e Komunës përveç të dhënave që kanë gabime teknike sic jane hartat e ndryshme(p.sh harta nr 6 e ne tekst I referohet hartës nr4), kemi edhe të dhëna të vjetruara që nuk janë të azhuruara me vitet e fundit, siç janë të dhënat nga fusha e arsimit e shëndetësisë,të paraqitura me statistika të vitit 2021.
- Sa I përket pjesës së Turizmit, të dhënat e paraqitura I referohen një dokumenti, konkretisht Strategjisë së turizmit të vitit 2019-2021, që nuk është relevante për vitin 2024.
- Pjesa 3 – Popullsia - Te kjo pjesë kemi referim të statistikave të vitit 2011, që e bajnë dokumentin të papërdorshëm për vitet në vijim, meqë sigurisht që struktura dhe numri I popullsisë ka ndryshuar, sic e jep edhe Regjistrimi I Popullsisë I vitit 2024. Të merren të dhëna statistikore nga regjistrimi I fundit.
- Pjesa 4- Gjendja e Mjedisit - Te pjesa e Ndotjes së ujrave jepet një përshkrim general për ndotjen mirëpo jo për ndotjen e lumit Llap dhe lumenjve tjerë të vegjël, të dhëna të domosdoshme për një PLVM.
- Cilësia e ajrit- edhe në këtë pjesë mungon një analizë ë mirëfilltë e ndotjes së ajrit per Komunën e Podujevës, nuk kemi të dhëna se kush janë ndotësit, sasia e ndotjes e elemente të tjera të rëndësishme.
- Zhurma- edhe në këtë pjesë mungojnë të dhënat e sakta për Podujevën, cilët janë shkaktarët e zhurmës, cila është lartësia e zhurmës e matur në Podujeve etj.
- Menaxhimi I Mbeturinave- të dhëna komplet të gabuara pasi I referohen një plani te vjetër të menaxhimit të të dhënave e jo Planit të ri të miratuar në 2023.
- Te kjo pjesë të bëhet fresikimi I të dhënave me planin e vitit 2023 si dhe me përfshirjen e të gjitha ekonomive familjare në mbledhjen e mebturinave, vendim I vitit 2024.

Podujevë, datë 20.12.2024

Raportin e përgatiti

Remzi Kodraliu

